



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 15.10.2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 2.10.2019 “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 15.10.2019, mori në shqyrtim Aktin Normativ nr. 3, datë 2.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Antoneta Dhima.

Për të prezantuar projektligjin në emër të Qeverisë, ishin të pranishëm Znj. Anila Denaj Ministër i Financave dhe Ekonomisë, Z. Elton Haxhi Zv. Ministër i Financave dhe Ekonomisë si dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Akti normativ është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normative.

Qëllimi

Qëllimi i aktit normative është përjashtimi nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore.

Kjo nismë ligjore ka marrë shkas nga situata e krijuar si pasojë e dëmtimeve të pësura në shumë banesa pas tërmetit të fuqishëm të datës 21 shtator 2019, dëmtime të cilat janë evidentuar dhe identifikuar si të tilla nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Përmes këtij akti normative mundësohet zgjidhja e problematikave të krijuara nga tërmeti si më lart u evidentua por gjithashtu mundësohet një zgjidhje e përhershme e të gjitha rasteve të ngjashme që mund të ndodhin në të ardhmen përmes parashikimit të përjashtimit nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për investimet e destinuara për qëllime banimi, të cilat kanë si qëllim ndërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore.

Përmbajtja e aktit normativ

Akti normativ përbëhet nga 3 nene gjithsej.

- Në nenin 1 parashikohet që investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile, do të përjashtohen nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.
- Në nenin 2, të aktit normativ, parashikohet shtimi i një dispozite kalimtare në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, për përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të të gjithë personave, që aplikojnë për t’u pajisur me leje për ndërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, si pasojë e tërmetit të fuqishëm të datës 21 shtator 2019.
- Në nenin 3 parashikohet hyrja në fuqi e aktit normativ.

IV. Efektet financiare

Efektet e të ardhurave dhe të shpenzimeve nga zbatimi i aktit normativ do të përfshihen në programin e miratuar të buxhetit për institucionet qendrore e vendore.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij u shpreh se akti normativ i propozuar nga Këshilli i Ministrave ka shtuar në grupin e përjashtimeve nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë edhe investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore. Nisma ka marrë shkas nga situata e krijuar si pasojë e dëmtimeve të pësura në shumë banesa pas tërmetit të fuqishëm të datës 21 shtator 2019, dëmtime të cilat janë evidentuar dhe identifikuar si të tilla nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Arësytimi i nevojës dhe urgjencës.

Akti normativ është në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili ka vlerësuar mundësinë e prezencës së rrethanave specifike të “nevojës” dhe “urgjencës”, duke përcaktuar se: *“Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.”*

Akti normative, nr. 3, datë 2.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, aktualisht është publikuar në Fletoren Zyrtare 137 dhe Kuvendi është brenda afateve Kushtetuese për ta shqyrtuar atë.

Për sa më sipër, ndërhyrja e shtetit për pajisjen e menjëhershme me lejet e ndërtimit përkatëse dhe për fillimin e punës për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e banesave të dëmtuara është dhe përbën realisht një nevojë dhe situatë emergjente pasi nevojitet që sa më shpejt të jetë e mundur, të gjithë banorët e prekur nga këto dëmtime të sistemohen në banesa dhe tiu nënshtrohen kushteve normale të jetesës.

Kjo nevojë dhe urgjencë, bëhet akoma edhe më e evidente duke ditur se dimri është afër dhe ndërhyrja sa më e shpejtë për të evituar vijimin e kësaj situatë në periudhën e dimrit është një domosdoshmëri për Qeverinë dhe për organet e vetëqeverisjes vendore.

Për sa më sipër, vlerësohet nuk ka asnjë dyshim se realisht ekzistonte “nevoja” dhe “urgjenca” dhe se janë plotësuar të gjitha kushtëzimet e nenit 101 të Kushtetutës.

Për të mundësuar përcaktimin e kushteve, rregullave dhe dokumentacionin e nevojshëm për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, Këshilli i Ministrave do të procedojë me miratimin e vendimit përkatës.

Diskutimet në komision

Pas dëgjimit të relatorit të çështjes, anëtarët e komisionit, shprehën vlerësimin e tyre lidhur me aktin normativ dhe e përkrahën këtë iniciativë të Qeverisë, por gjithashtu ngritën për përfaqësuesit e Qeverisë, edhe disa pyetje konkrete të cilat lidheshin direkt me zbatimin e këtij akti normativ.

Më konkretisht anëtarët e komisionit, kërkuar informacion mbi faktin nëse ka përfunduar evidentimi i banesave të dëmtuara nga tërmeti i datës 21 shtator 2019 dhe nëse aktualisht ka një preventiv paraprak të shumës respektive që do të nevojitet për rindërtim, riparim apo restaurim e këtyre banesave.

Informacion u kërkuar gjithashtu edhe lidhur me miratimin ose jo të akteve nënligjore të nevojshme që do të bënin të mundur zbatimin korrekt të këtij akti normativ.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, informoi komisionin se evidentimi i dëmeve dhe i banesa të dëmtuara që kanë nevojë për rindërtim, riparim apo restaurim, ka filluar nga organet e qeverisjes vendore menjëherë pas tërmetit dhe po vazhdon puna për evidentimin përfundimtar të tyre. Për momentin nuk ka një preventiv final të përllogaritur që të mundësonte çeljen e fondeve.

Pavarësisht nga kjo, ka një përllogaritje të kostove të rindërtimit për zonën e Korçës, metodologji kjo që mendohet se mund të përdoret edhe për përllogaritjen e kostove edhe në zonat e tjera të vendit madje kjo metodologji mund të shërbejë edhe për të negociuar me institucionet ndërkombëtare për fondet e nevojshme.

Një shqetësim tjetër i ngritur gjatë shqyrtimit në komision të aktit normative, lidhej me faktin nëse është vlerësuar sa duhet, shmangia e fenomeneve abuzimeve me fondet që do të alokohen në rastet e rindërtimit. Pra do të duhet që të përcaktohet qartë që në rastin e rindërtimeve, përfituesit e fondeve duhet të kenë kufizimin për sipërfaqen e rindërtimit të banesës brenda sipërfaqeve ekzistuese dhe jo në sipërfaqe më të mëdha.

Në kushtet kur, ky kufizim nuk është vendosur në dispozitat e aktit normative, komisioni i rekomandoi përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që në vendimin e Këshillit të Ministrave, përmes të cilit do të përcaktohet rregullat procedurale për zbatimin e aktit normative, të vendoset edhe ky përcaktim apo kufizim.

Në përfundim nga komisioni u vlerësua se nxjerrja e aktit normativ, nga Këshilli i Ministrave, ka shkurtuar së ndjeshmi kohën e ndërhyrjes dhe ndërmarrjen e masave nga organet e qeverisjes vendore për të proceduar me eliminimin e pasojave.

Në rast se nisma do të paraqitej si një projektligj i propozuar nga Këshilli i Ministrave, në rrugë normale, koha në dispozicion të Kuvendit për ta miratuar atë si dhe procedurat e mëtejshme të parashikuara në Kushtetutë për miratimin dhe hyrjen në fuqi të

aktit do të vononin së tepërmi ndërmarrjen e masave emergjente dhe të nevojshme për qytetarët.

Kjo iniciativë është në përputhje edhe me frymën e transmetuar përmes nenit 59 të Kushtetutës lidhur me objektivat social të tij.

VI. *Përfundime*

Për gjithë sa më sipër analizova, duke vlerësuar se miratimi i këtij akti normativ, ishte nevojë dhe urgjencë e Qeverisë për mundësimin e marrjes së masave emergjente për rastet e një fatkeqësie natyrore siç ishte tërmeti i para pak kohëve, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi aktin normativ nr. 3, datë 2.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

RELATOR

KRYETAR

Antoneta DHIMA

Arben AHMETAJ